

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Sabri Rrapi,	Anëtar i “ “
Zija Vuci,	Anëtar i “ “
Hajredin Fuga,	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço,	Anëtar i “ “
Kujtim Puto,	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi,	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi,	Anëtar i “ “

me sekretare Drita Panda e Arbenka Lalica, më datat 18.9.2000 dhe 17.10.2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.54 Akti që i përket:

KËRKUESE: GJYKATA E RRETHIT TIRANË

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, në mungesë
2. KËSHILLI I MINISTRAVE, në mungesë
3. ADMINISTRATORËT E SHOQËRISË “M.LEKA”, përfaqësuar nga juristi Petrit Gaçe, me autorizim
4. FERID TAHJA, LULËZIM SHALA, SHPËTIM STERMASI, YLÇEZAR TORA, përfaqësuar nga avokat Spartak Ngjela.

O B J E K T I:

Papajftueshmëria me Kushtetutën (me nenet 7, 11/1,3, dhe 41/3) të ligjit nr.8472, datë 8.4.1999 “Për kthimin në shoqëritë huamarrëse të vlerave financiare të përfituara nga ana e personave fizikë e juridikë, nga shitja e pasurisë apo transaksioneve të pronësisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi përfaqësuesin e subjekteve të interesuara, avokatin Spartak Ngjela, që kërkoi deklarinimin e ligjit të papajftueshëm me Kushtetutën, përfaqësuesin e administratorëve që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe si e bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Gjykata e Rrethit Tiranë, më datë 30.6.2000, ka marrë në shqyrtim çështjen civile me palë: paditës, Shoqëria “M.Leka”, në administrim dhe të paditur, Ferid Tahja, Lulëzim Shala, Shpëtim Stërmasi e Ylçezar Tora, me objekt deklarinimin e pavlefshmërisë së veprimit juridik të shitblerjes. Pala paditëse, kërkesën për pavlefshmëri të shitjes e bazon në ligjin nr.8472. datë 08.04.1999 dhe nenin 92 të Kodit Civil, duke pretenduar se çmimi real i objektit të shitur nuk është 1 600 000 dollarë por 70 000 000 lekë. Gjykata e rrethit arsyeton në vendim se gjatë gjykimit, të paditurit dhe avokati i tyre paraqitën kërkesë me shkrim për pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese për shfuqizimin e ligjit nr.8472, datë 08.04.1999, pasi ai bie ndesh me nenet 7,11/3 dhe 41/3 të Kushtetutës. Më konkretisht, sipas tyre, ky ligj cënon parimin kushtetues të lirisë ekonomike, të pavarësisë së pushtetit gjyqësor si dhe parimet juridiko-civile në tërësi.

Gjykata Kushtetuese, pasi i shqyrtoi në tërësi shkaqet e parashtruara në vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe pretendimet e subjekteve të interesuara të bëra në seancë dhe meqenëse gjatë votimit votat u ndanë në mënyrë të tillë që asnjë përfundim i çështjes nuk u votua nga shumica e kërkuar dhe ekziston pamundësi objektive për të riçelur seancën, është e detyruar në bazë të nenit 74 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të

Republikës së Shqipërisë”, të vendosë refuzimin e kërkesës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31/a dhe 132 të Kushtetutës si dhe nenit 74 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S I:

Refuzimin e kërkesës.

Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 17.11.2000

Nr.54 i Regj.Themeltar.

Nr.81 i Vendimit